



LIGJ
Nr. 149/2014

**PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT NR.
2 TË MARRËVESHJES SË NDIHMËS
PËR OBJEKTIVA ZHVILLIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
SHTETEVE TË BASHKUARA TË
AMERIKËS “PËR FORCIMIN E
SHTETIT TË SË DREJTËS DHE
QEVERISJEN E MIRË DHE KRIJIMIN E
KUSHTEVE PËR NJË RRIJJE
EKONOMIKE ME BAZË TË GJERË
DHE TË QËNDRUESHME”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi nr. 2 i marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës “Për forcimin e shtetit të së drejtës dhe qeverisjen e mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë dhe të qëndrueshme”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8796, datë 18.11.2014
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani

Marrëveshje e Ndihmës së USAID-it nr. 182-DOAG-13-003

AMENDIM NUMËR DY
I MARRËVESHJES SË NDIHMËS

PËR OBJEKTIVA ZHVILLIMI NDËRMJET
QEVERISË SË SHTETEVE TË
BASHKUARA TË AMERIKËS DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR
FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS
DHE QEVERISJES SË MIRË DHE
KRIJIMIN E KUSHTEVE PËR NJË RRIJJE
EKONOMIKE ME BAZË TË GJERË DHE
TË QËNDRUESHME

Datë 30 shtator 2013

Amendim numër dy i marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi ndërmjet Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës që vepron nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar "USAID" dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron nëpërmjet Ministrisë së Financave (më poshtë e quajtur "Përfituesi i Ndihmës")

Neni 1

Qëllimi i amendimit

Ky amendim numër dy i marrëveshjes së ndihmës së USAID për objektiva zhvillimi, i datës 30 shtator 2013 "Marrëveshja", bëhet midis palëve me qëllim që t'i japë Përfituesit të Ndihmës një ndihmë shtesë për një milion e katërqind e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy dollarë amerikanë "USD" (\$, 1,407,662) dhe të modifikojë buxhetin në përputhje me sa më sipër. Kjo shumë shtesë e fondeve e bën shumën e angazhuar të marrëveshjes deri në këtë datë, në një shumë që nuk kalon njëmbëdhjetë milionë e treqind e trembëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre dollarë amerikanë "USD" (\$ 11,313,953).

Neni 2

Kontributet e palëve

Neni 3, seksioni 3.1 (a) I Marrëveshjes fshihet tërësisht dhe teksti në vazhdim e zëvendëson atë.

"Seksioni 3.1. Kontributi i USAID-it

a) Granti. Për të ndihmuar arritjen e objektivave të vendosura në këtë Marrëveshje, USAID në përputhje me aktin e ndihmës së huaj të vitit 1961, të ndryshuar, i jep Përfituesit të Ndihmës, sipas kushteve të Marrëveshjes, një shumë që nuk kalon njëmbëdhjetë milionë e



treqind e trembëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre dollarë amerikanë "USD" (\$11,313,953) (Granti).

zgjeruar, seksioni III, fshihet tërësisht dhe teksti në vazhdim e zëvendëson atë.

III. PLANI FINANCIAR

Neni 3 Plani financiar

Plani financiar për kryerjen e objektivave dhe të rezultateve, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Plani financiar sipas shtojcës 1, përshkrimit të

Plani financiar i Marrëveshjes së Ndihmës për Objektiva Zhvillimi			
Nr.	Fusha e Programit	Vitit fiskal (VF) 2013	Totali VF2013-VF2016
1	Shteti ligjor dhe të drejtat e njeriut	\$ 2,189,000	\$5,339,000
2	Qeverisja e mirë	\$ 4,557,662	\$12,345,662
3	Shoqëria Civile	\$0	\$1,000,000
4	Tregtia dhe Investimet	\$500,000	\$1,500,000
5	Spektori Financiar	\$1,250,000	\$1,950,000
6	Konkurrueshmëria e sektorit privat	\$1,817,000	\$4,817,000
7	Mbështetja për programin	\$1,000,291	\$3,000,000
	Totali	\$11,313,953	\$29,951,662



Neni 4

Termet dhe kushtet e tjera

Përveç amendimeve në këtë dokument, të gjitha termat dhe kushtet e tjera të Marrëveshjes mbeten plotësisht në fuqi. Të gjitha termat me germa kapitale në këtë amendim numër dy do të kenë kuptimet që u jepen në Marrëveshje.

Në dëshmi të kësaj, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Përfituesi i Ndihmës, secili duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë bërë që ky amendim Numër Dy i Marrëveshjes të nënshkruhet në emër të tyre dhe të dërgohet në ditën dhe vitin e cituar më sipër.

QEVERIA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

Nga

Datë

Pozicioni: Drejtor Misioni në Detyrë

USAID Shqipëri

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga

Datë

Emri: Shkëlqim Cani

Pozicioni: Ministër i Financave